

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2011

SESIONI II

(I DETYRUAR)

VARIANTI A

E premte, 9 shtator 2011

Ora 10.00

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Shkolla e mesme teknike profesionale (3+2) dhe 5-vjeçare

Udhëzime për nxënësin

Testi është i ndarë në dy pjesë: në poezi dhe në prozë.

Testi në total ka **25 pyetje**.

Në të dyja pjesët ka pyetje me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në pyetjet me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8a	8b	8c	9a	9b	10a	10b	11a
Pikët															
Kërkesa	11b	11c	12a	12b	12c	13	14	15	16	17	18	19a	19b	20a	20b
Pikët															
Kërkesa	21a	21b	21c	22a	22b	23a	23b	23c	23d	24	25a	25b	25c	25d	
Pikët															

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

PJESA I**Gjergj Elez Alia
(fragment)**

I- Qat'herë trimi a'nisë me dredhë tu shpija
edhe shokt'të gjith m'i ka bashkue:
"Po ndigjoni, more shokt' e mij:
falë u kofshin sarajet e mija,
falë u kofshin tanë paret e mija,
e u koftë falë krejt malli e gjaja e shpisë,
- amanet motra e Gjergj Elez Alisë!"
Edhe shtatit trim i paska dhanun,
motërzezën ngrykas kesh me u marrun,
të dy zemrat priherë po janë ndalun!
Gjamë të madhe shokët qi kanë ba,
Po ia çilin një vorr t'bukur t'gjanë,
vlla e motër ngrykas për me i xanë.
E i muranë t'bukur e kanë mbarue,
vlla e motër kurr mos me u harrue.
E i bli t'bukur qi m'ia vndajnë tu kryet,
zogu i verës gjithmonë me pushue.

II- Kur ka nisun mali me u dushkue,
a ndalë qyqja n'muranë t'vorrit t'ri!
Ka gjetë blinin të tanë degash tha.
Ka flurue përmbi' i saraj të zi,
ka gjetë kulmin të tanë shembë përdhe.
M'nji prezor si m'paska hype,
ka përbe shtegtarin kah po shkon:
"Amanet, more shtegtari i malit,
n'kofsh tuj kndue ksajt, kajkën për me e pushue
n'kofsh tu' kajtë ksajt, gjamën për me e xanë!
Kah kërkova gjithkund bjeshkë e m'bjeshkë,
kah verova gjithkund vrri e n'vrri.
kah mjerova gjithkund shpi e n'shpi,
kërkund s'ndesha n'Gjergj Elez Ali!"

Për pyetjet nga 1-7 rrethoni **vetëm** alternativën e saktë.

1. Gjergj Elez Alia është: 1 pikë
- A) këngë hyrëse e Ciklit të Kreshnikëve
 - B) këngë hyrëse e këngëve historike
 - C) këngë mbyllëse e këngëve të dasmave
 - D) këngë hyrëse e këngëve të motmotit
2. Gjergj Elez Alia është personazhi që lufton për: 1 pikë
- A) të ruajtur traditën e këngëve popullore
 - B) pasuri
 - C) atdhe dhe familje
 - D) të sunduar vende të tjera
3. Këngëtari popullor thotë: *trim mbi trima Gjergj Elez Alia*, sepse vlerëson: 1 pikë
- A) faktin që Gjergji kishte kohë pa luftuar
 - B) fjalët që Gjergji u thotë shokëve të tij
 - C) vdekjen e menjëhershme të vëllait dhe të motrës
 - D) mbijetesën e Gjergjit në raport me vuajtjen dhe angazhimin
4. Në këtë këngë është hiperbolizuar fakti që: 1 pikë
- A) Gjergji del në betejë nga dashuria për të motrën
 - B) Gjergj Elez Alia fiton me Bajlozin megjithëse ka 9 plagë
 - C) Gjergjit ia kërkojnë dyluftimin
 - D) Gjergji edhe mund të vdesë duke luftuar
5. Subjekti i kësaj kënge karakterizohet nga: 1 pikë
- A) zhveshja nga ngjarje të parëndësishme
 - B) zhveshja nga figuracioni
 - C) dhënia e disa linjave paralele subjektore
 - D) dhënia me imtësi e çdo ngjarjeje të subjektit
6. Në cilën mënyrë është folja *paska dhanum*? 1 pikë
- A) lidhore
 - B) dëftore
 - C) habitore
 - D) dëshirore
7. Fjala *gjithkund* i përket klasës së: 1 pikë
- A) emrit
 - B) ndajfoljes
 - C) foljes
 - D) përemrit

8. Cilat janë tri momentet kyçe të subjektit në këtë fragment?

- a) _____ 1 pikë
- b) _____ 1 pikë
- c) _____ 1 pikë

9. Identifikoni dy detaje në fillim të pjesës së dytë të fragmentit që tregojnë se tashmë është një stinë tjetër.

- a) detaji 1: _____ 1 pikë
- b) detaji 2: _____ 1 pikë

10.

- a) Gjeni togfjalëshin që tregon pemën e mbjellë te kryet e motrës dhe të vëllait.
Si është formuar ai? 3 pikë

* togfjalëshi është: _____

* formimi i tij: _____

- b) Shpjegoni me fjalët tuaja kuptimin e vargut të fundit: *Kërrkund s'ndesha n'Gjergj Elez Ali!*” 1 pikë

11. Cila është figura tingullore e përdorur në vargjet; *N'kofsh tuj kndue ksajt, kajkën për me e pushue/N'kofsh tu' kajtë ksajt, gjamën për me e xanë*. Cili është roli i kësaj figure?

- a) figura: _____ 1 pikë
- b) roli: _____ 1 pikë
- c) Gjeni një anaforë të përdorur në këtë fragment. 1 pikë

12.

- a) Si tingëllon amaneti që Gjergji u lë shokëve? 1 pikë

- b) Cili është dallimi midis fjalëve *kjaj dhe gjamë*? 1 pikë

- c) Pse humbja e Gjergjit trajtohet si gjamë? 1 pikë

PJESA II**Ernest Heminguej****Plaku dhe Deti
(fragment)**

*Plaku nuk donte ta shikonte më peshkun tani që ishte shëmtuar. Kur i kishin sulmuar peshkun, iu duk sikur sulmuan atë vetë.

Por, sidoqoftë, unë e vrava peshkaqenin që sulmoi peshkun tim, mendoi. Dhe ai ishte *dentuso* më i madh që kam parë ndonjëherë. Dhe e di Perëndia sa peshkaqenë të mëdhenj kam parë në jetë.

*E kisha punën kaq mirë, sa që s'mund të vazhdonte kështu, sepse e mira nuk vazhdon gjatë. Do të doja që e gjitha kjo të ishte një ëndërr dhe që të mos e kisha kapur kurrë këtë peshk dhe të flija i vetëm mbi shtratin tim, mbi gazetën.

- Por njeriu nuk ëshë krijuar për të pësuar disfatë, tha. Njeriun mund ta asgjësosh, por jo ta mposhtësh. Megjithatë më vjen keq që e vrava peshkun, mendoi. Tani të keqen e kam përpara dhe unë s'kam tani as fuzhnjën. *Dentuso* që i egër dhe i shkathët dhe i fortë dhe i zgjuar. Por unë isha më i zgjuar se ai. Ndoshta jo, mendoi. Ndoshta unë isha vetëm më i armatosur.

*- Mos u mendo, plak, tha me zë të lartë. Lundro në drejtimin që ke marrë dhe përballo të keqen kur të të vijë.

Por unë duhet të mendoj, mendoi. Sepse kjo është e vetmja gjë që më ka mbetur. Kjo dhe bejsbolli. Kam qejf të di, se a do t'i pëlqente Di Maxhios së madh, mënyra se si e godita peshkaqenin në tru. Kjo s'ishte ndonjë gjë e madhe, mendoi. Çdo njeri mund ta bënte. Por ti kujton se duart e mia më penguan aq sa të pengon ty kalloja e kockës? Këtë s'mund ta di. Asnjëherë s'më ka pësuar ndonjë të keqe thembra e këmbës, me përjashtim të asaj here kur më kafshoi peshku elektrik, kur unë e shkela ndërsa po lahesha, dhe që m'u paralizua këmba gjer te gjuri dhe që më dhembti aq sa nuk e duroja dot.

- Mendo ndonjë gjë më të gëzueshme, o plak, tha. Çdo minutë që kalon je më afër shtëpisë. Tani që humbe pesëmbëdhjetë kile peshk, lundron më lehtë.

Plaku e dinte mirë se ç'mund të ndodhte kur të arrinte në mesin e rrymës. Por s'kish ç'të bënte.

- Ke ç'të bësh, tha me zë të lartë. Mund të lidhësh thikën me njëren lopatë.

Kështu bëri, duke mbajtur timonin në dorë dhe duke shkelur me këmbë litarin e pëlhurës.

- Ja pra, tha. Vërtet jam plak tani. Por unë jam i çarmatosur.

*Era frynte tani e freskët dhe ai lundronte shpejt. Vështronte vetëm pjesën e përparme të peshkut dhe shpresa iu kthye përsëri.

Është marrëzi të mos kesh shpresë, mendoi. Veç kësaj, besoj se kjo është mëkat. Mos mendo për mëkat, tha me vete. Tani ke telashe të tjera, përveç mëkatit. Nga mëkatet nuk kuptoj shumë.

Unë nuk i kuptoj mirë mëkatet dhe s'ma merr mendja që besoj në to. Ndoshta bëra mëkat që vrava peshkun. Besoj se mëkat është, megjithëse e vrava që të nxjerr bukën dhe që të ushqehen me të shumë njerëz.

Për pyetjet nga 13-18 rrethoni **vetëm** alternativën e saktë.

13. Motivet kryesore të tematikës së veprës së Heminguejit janë: **1 pikë**

- A) pasioni dhe krimi
- B) jeta dhe pasjeta
- C) lindja dhe vdekja
- D) ekzistenca dhe shpresa

14. Hemingueji konsiderohet si shkrimtar: **1 pikë**

- A) romantik
- B) klasikist
- C) i brezit të humbur
- D) realist

15. Sipas plakut punët nuk po i ecnin mirë, sepse: **1 pikë**

- A) e mira nuk vazhdon gjatë
- B) e mira nuk fiton kurrë mbi të keqen
- C) e keqja është e vetmja që sundon botën
- D) ai nuk dëshironte më që punët t'i ecnin mirë

16. Roli i përemrit pronor në togun *peshkun tim* është të nxjerrë në pah: **1 pikë**

- A) vlerën e peshkut
- B) lidhjen e plakut me detin dhe gjallesat aty
- C) inatin e plakut për llojet e peshqve
- D) vlerën e peshkaqenit

17. Shprehja e plakut: *Dhe e di Perëndia sa peshkaqenë të mëdhenj kam parë në jetë*, dëshmon për: **1 pikë**

- A) përvojë të gjatë në det
- B) paburrërinë e plakut
- C) jetën e çuar dëm
- D) vdekjen që e pret

18. Plaku e vrau peshkaqenin sepse: **1 pikë**

- A) nuk e adhuronte
- B) këtë gjë nuk e kishte bërë kurrë
- C) nuk e mendoi shumë
- D) ai i vrau peshkun e tij

19. Pse plakut iu duk sikur e kishin sulmuar atë vetë? Jepni dy arsye për këtë.

a) _____ **1 pikë**

b) _____ **1 pikë**

20. Gjeni në fragment dy shembuj të mënyrës së komunikimit të plakut.

a) _____ 1 pikë

b) _____ 1 pikë

21. Për çfarë flet dhe mendon plaku në paragrafin e dytë? Cili është raporti mes koncepteve që ai trajton aty? Shpjegoni shprehjen e plakut: *njeriun mund ta asgjësosh, por jo ta mposhtësh*.

a) _____ 1 pikë

b) _____ 1 pikë

c) _____

_____ 1 pikë

22. Shpjegoni dy anët e mendimit të plakut në fund të fragmentit.

a) _____ 1 pikë

b) _____ 1 pikë

23. Në cilën shkallë është mbiemri në fjalinë e mëposhtme: *Dhe ai ishte dentuso më i madh që kam parë ndonjëherë?* Autori thotë *më i madh* në raport me kohën apo me njerëzit? Cila është fjala që e ndërton këtë raport dhe në cilën klasë bën pjesë ajo?

a) _____ 1 pikë

b) _____ 1 pikë

c) _____ 1 pikë

d) _____ 1 pikë

24. Identifikoni një tipar të stilit të Heminguejit që del në këtë fragment.

_____ 1 pikë

